

VENDIM
Nr. 17, datë 28.4.2023

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME
SARANDË SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM-së nr. 958); si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 28.4.2023, pasi shqyrtoi çështjen me objekt “Mbi miratimin e vendimit ‘Për licencimin e shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Sarandë sh.a.’”,

KONSTATON SE:

1. Shoqëria rajonale Ujësjellës-Kanalizime Sarandë sh.a., me shkresën nr. 144 prot., datë 23.3.2023, si dhe plotësimet e dërguara me nr. prot. 154, datë 30.3.2023, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për licencim.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim të shoqërisë rajonale UK Sarandë sh.a. në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 302, datë 11.5.2022, “Për politikat kombëtare për riorganizimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit, Trajtimit dhe Përpunimit të Ujërave të Ndotura” (VKM nr. 302).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria rajonale Ujësjellës-Kanalizime Sarandë sh.a. (NUIS: M24828802U) është themeluar më datë 27.12.2022, me aksionarë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me 51%, bashkitë Sarandë me 34.6%, Konispol me 4.49%, Delvinë me 5.28 dhe Finiq 4.61%;

b) Shoqëria rajonale UK Sarandë sh.a. ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 153,299 banorë të bashkive Sarandë, Konispol, Delvinë; Finiq;

c) Drejtues teknik i shoqërisë z. Sheme Lulo është diplomuar në Universitetin Politeknik të Tiranës, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, Dega Hidroteknikë, në vitin 1988 dhe plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion;

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për herë të parë ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e shoqërisë rajonale UK Sarandë sh.a., të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrin rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe të kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121), për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e shoqërisë rajonale UK Sarandë sh.a është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Sarandë sh.a. me NUIS: M24828802U, në kategoritë:

- a) Kategoria A, “Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik”;
- b) Kategoria C, “Për largimin e ujërave të ndotura”;

2. Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Sarandë sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

- a) Drejtues ligjor: Armando Goxharaj;
- b) Drejtues teknik: Sheme Lulo.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Sarandë sh.a. janë bashkitë Sarandë, Konispol, Delvinë, Finiq.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Vendimi i KKRR-së nr. 320, datë 20.8.2021, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Delvinë sh.a.”, shfuqizohet;

6. Drejtuesi ligjor i shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Sarandë sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

7. Ngarkohet drejtorja Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Sarandë sh.a për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani